

1. POLITIKA E PRIVATËSISË

Banka Jet Sh.A. ("Jet", "ne", "Banka") respekton dhe mbron privatësinë e çdo individi që viziton website-in tonë ose ndërvepron me ne përmes kanaleve tona digjitale. Ne jemi të përkushtuar të trajtojmë të dhënat personale në mënyrë të ligjshme, të drejtë dhe transparente, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, përfshirë Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR), si dhe aktet përkatëse nënligjore.

Kjo Politikë Privatësie shpjegon se si dhe për çfarë qëllimesh Jet mbledh, përdor, ruan dhe mbron të dhënat personale, kur ju:

- vizitoni website-in tonë;
- regjistroheni në waiting list ose shprehni interes për lançimin e Bankës;
- na kontaktoni për informacion, karrierë ose çështje të tjera.

Në këtë fazë, Jet ndodhet në periudhë përgatitore (para-lançim) dhe nuk ofron ende produkte apo shërbime bankare aktive për publikun.

Çdo përpunim i të dhënave personale përmes website-it kufizohet në qëllime informuese, komunikimi dhe ndërtimi të marrëdhënieve paraprake, dhe nuk krijon marrëdhënie kontraktuale apo klient-bankë.

Jet përpunon vetëm ato të dhëna personale që janë të nevojshme, proporcionale dhe të përshtatshme për qëllimet e deklaruara, duke zbatuar parimet e minimizimit të të dhënave, kufizimit të qëllimit dhe ruajtjes për një periudhë të kufizuar. Përpunimi i të dhënave personale bazohet në pëlqimin e shprehur nga subjektet e të dhënave, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe.

Jet ka ndërmarrë masa të përshtatshme teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale dhe për të mbrojtur këto të dhëna nga akseset e paautorizuara, humbja, keqpërdorimi apo zbulimi i paligjshëm.

Kjo Politikë Privatësie është e aksesueshme në çdo kohë përmes website-it dhe mund të përditësohet periodikisht për të reflektuar ndryshime në legjislacion, në mënyrën e përpunimit të të dhënave ose në statusin e Bankës. Çdo ndryshim material do të komunikohet në mënyrë të qartë dhe transparente.

2. STATUSI AKTUAL I JET BANK

Jet Bank është e licensuar nga Banka e Shqipërisë, me Vendimarrjen e Këshillit Mbikëqyrës në mbledhjen e datës 25 mars 2026, duke përmbushur të gjitha kërkesat rregullatore për ushtrimin e aktivitetit bankar në Republikën e Shqipërisë.

Në këtë fazë, banka është në procesin e finalizimit të përgatitjeve për fillimin e aktivitetit, përfshirë ndërtimin dhe testimin e infrastrukturës operacionale. Kjo përfshin sistemet teknologjike, proceset e brendshme, politikat dhe procedurat rregullatore, si dhe mekanizmat e kontrollit dhe përputhshmërisë, në përputhje me kërkesat e Bankës së Shqipërisë dhe kuadrin ligjor në fuqi.

Website-i i Jet Bank shërben si platformë informative dhe komunikimi, duke prezantuar bankën dhe duke mundësuar regjistrimin në "Listën e Pritjes". Kjo listë u jep mundësinë individëve të shprehin interesin dhe të regjistrohen për të qenë ndër të parët që do të aksesojnë shërbimet bankare pas fillimit zyrtar të aktivitetit.

Deri në fillimin e plotë të operimit, Jet Bank nuk ofron dhe nuk promovon produkte apo shërbime bankare aktive për publikun. Çdo informacion i publikuar në website nuk përbën ofertë, ftesë për kontraktim apo këshillë financiare.

3. ÇFARË TË DHËNASH PERSONALE PËRPUNOJMË

Në kuadër të funksionimit të website-it dhe të aktivitetit "para-lançim" të Jet Bank, ne përpunojmë vetëm ato të dhëna personale që janë të nevojshme dhe proporcionale për qëllimet për të cilat mbledhen.

Në veçanti, përmes website-it mund të përpunojmë kategoritë e mëposhtme të të dhënave personale:

- Të dhëna identifikuese, të ofruara drejtpërdrejt nga ju, si p.sh. emër dhe mbiemër, në rastet kur regjistroheni në waiting list, na kontaktoni ose aplikoni për pozicione pune.
- Të dhëna kontakti, të tilla si adresa e email-it dhe/ose informacione të tjera kontakti që ju vendosni të na komunikoni, me qëllim që ne t'ju informojmë mbi lançimin e Bankës, t'u përgjigjemi kërkesave tuaja ose t'ju kontaktojmë në lidhje me aplikimet për karrierë.
- Të dhëna teknike dhe të përdorimit të website-it, të cilat mund të përfshijnë adresën IP, informacion mbi pajisjen dhe shfletuesin, si dhe të dhëna të mbledhura përmes cookies ose teknologjive të ngjashme. Këto të dhëna përpunohen vetëm në masën e nevojshme për funksionimin teknik të website-it dhe, për cookies jo thelbësore, vetëm pas dhënies së pëlqimit tuaj të shprehur, në përputhje me Cookie Policy.

Jet nuk përpunon të dhëna të kategorive të veçanta në kuptim të GDPR (si të dhëna shëndetësore, biometrike, bindje politike apo fetare) dhe nuk kërkon që të tilla të dhëna të komunikohen përmes website-it në këtë fazë.

Ne ju kërkojmë të mos na transmetoni përmes website-it asnjë informacion personal që nuk është i domosdoshëm për qëllimet e përmendura më sipër. Çdo e dhënë personale e dorëzuar në mënyrë vullnetare përpunohet në përputhje me këtë Politikë Privatësie dhe vetëm për qëllimin për të cilin është ofruar.

4. QËLLIMI I PËRPUNIMIT

Jet përpunon të dhënat personale të mbledhura përmes website-it vetëm për qëllime të përcaktuara, të ligjshme dhe të kufizuara, të cilat lidhen drejtpërdrejt me fazën para-lançim dhe përgatitjen për fillimin e aktivitetit bankar.

Në veçanti, të dhënat personale përpunohen për qëllimet e mëposhtme:

- Administrimin e waiting list, për të regjistruar dhe menaxhuar shprehjen e interesit nga individët që dëshirojnë të informohen mbi lançimin e Bankës dhe fillimin e ofrimit të produkteve dhe shërbimeve bankare, pa krijuar marrëdhënie kontraktuale në këtë fazë.
- Njoftimin për lançimin e Bankës dhe komunikime informuese të lidhura me këtë fazë paraprake, përfshirë dërgimin e informacioneve mbi statusin e Bankës, momentin e fillimit të aktivitetit dhe zhvillime të tjera të përgjithshme që lidhen me lançimin, në përputhje me pëlqimin e dhënë nga subjektet e të dhënave.
- Përgjigjen ndaj kërkesave për kontakt, përfshirë komunikimet e iniciuara nga vetë përdoruesit për të marrë informacion të mëtejshëm mbi Bankën, website-in ose procesin para-lançim.
- Menaxhimin e aplikimeve për karrierë, për qëllime rekrutimi dhe vlerësimi paraprak të kandidaturave, në përputhje me procedurat e brendshme dhe kërkesat ligjore në fuqi.
- Përpunimi i të dhënave për qëllime marketingu (pëlqim i veçantë), përfshirë dërgimin e komunikimeve promociionale ose informative në lidhje me lançimin e Bankës, zhvillimet e ardhshme apo produktet dhe shërbimet që mund të ofrohen pas marrjes së licencimit përfundimtar, realizohet vetëm mbi bazën e pëlqimit të veçantë dhe të shprehur të subjektit të të dhënave, në përputhje me nenin 6(1)(a) të GDPR.

- Ky pëlqim jepet përmes një checkbox-i të ndarë, të qartë dhe jo të parazgjedhur, i cili është i

dallueshëm nga pëlqimi i përgjithshëm për regjistrimin në waiting list ose përdorimin e website-it.

- Mosdhënia e këtij pëlqimi nuk ndikon në regjistrimin në waiting list dhe nuk kufizon aksesin në funksionalitetet e tjera të website-it.

- Subjekti i të dhënave ka të drejtë të tërheqë pëlqimin për marketing në çdo kohë, pa pasoja dhe pa cenuar ligjshmërinë e përpunimit të kryer përpara tërheqjes, përmes mekanizmave të thjeshtë dhe të aksesueshëm që do të vihen në dispozicion (p.sh. link "unsubscribe" ose kontakt përkatës).

Përpunimi i të dhënave personale nuk realizohet për qëllime të tjera të papërcaktuara ose të papajtueshme me ato të përmendura më sipër. Në rast se, në një fazë të mëvonshme, Jet synon të përdorë të dhënat personale për qëllime të ndryshme, subjektet e të dhënave do të informohen paraprakisht dhe, kur është e nevojshme, do t'u kërkohej pëlqimi përkatës.

5. BAZA LIGJORE

Të dhënat personale të mbledhura për qëllime marketingu dhe waiting list ruhen vetëm për periudhën e nevojshme dhe proporcionale për realizimin e këtyre qëllimeve, në përputhje me parimin e kufizimit të ruajtjes.

Në veçanti:

Privacy Policy – v.1.0 – Janar 2026

- të dhënat e mbledhura për waiting list ruhen deri në momentin e lançimit të Bankës dhe për një periudhë të arsyeshme pas tij, jo më gjatë se 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e lançimit, për të mundësuar komunikimin informues me individët e regjistruar;
 - të dhënat e përpunuara për qëllime marketingu, mbi bazën e pëlqimit të veçantë, ruhen deri në momentin e tërheqjes së pëlqimit nga subjekti i të dhënave, ose për një periudhë maksimale të arsyeshme, në përputhje me politikat e brendshme të Bankës dhe legjislacionin në fuqi.
- Pas përfundimit të afateve përkatëse të ruajtjes, ose në rast të tërheqjes së pëlqimit, të dhënat personale fshihen ose anonimizohen në mënyrë të sigurt, përveç rasteve kur ruajtja e tyre është e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve ligjore ose rregullatore që i ngarkohen Bankës.

6. NDARJA E TË DHËNAVE

Jet i trajton të dhënat personale me një nivel të lartë kujdesi dhe nuk i shpërndan, shet apo transferon këto të dhëna tek palë të treta për qëllime të tyre të pavarura.

Në kuadër të funksionimit të website-it dhe përmbushjes së qëllimeve të përpunimit të përshkruara në këtë Politikë Privatësie, të dhënat personale mund të aksesohen ose përpunohen nga palë të treta që veprojnë si ofrues shërbimesh për Bankën, vetëm në masën që është e nevojshme për ofrimin e shërbimeve përkatëse.

Këta ofrues shërbimesh mund të përfshijnë, ndër të tjera:

- ofrues të shërbimeve të hosting-ut dhe infrastrukturës IT;
- ofrues të shërbimeve të mirëmbajtjes teknike dhe suportit të website-it;
- ofrues të zgjidhjeve teknologjike për menaxhimin e komunikimeve ose aplikimeve (p.sh. platforma email ose karriere), vetëm nëse dhe në masën që përdoren.

Të gjithë ofruesit e shërbimeve përpunojnë të dhënat personale vetëm mbi udhëzimet e Jet nuk fitojnë asnjë të drejtë pronësie mbi këto të dhëna dhe janë të lidhur me Bankën përmes marrëveshjeve kontraktuale që përfshijnë detyrime të qarta për:

- konfidencialitetin e të dhënave;

- zbatimin e masave të përshtatshme teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave;
- përputhshmërinë me kërkesat e GDPR dhe legjislacionit në fuqi.

Jet siguron që aksesit i këtyre palëve të treta në të dhënat personale të jetë i kufizuar, i kontrolluar dhe i monitoruar, dhe vetëm për periudhën e nevojshme për ofrimin e shërbimeve përkatëse.

Në rastet kur përpunimi i të dhënave personale mund të përfshijë transferime jashtë Zonës Ekonomike Evropiane (EEA), Jet do të sigurojë që këto transferime të kryhen vetëm në përputhje me kërkesat e GDPR, duke zbatuar garancitë e duhura ligjore dhe teknike.

7. TË DREJTAT TUAJA SI SUBJEKT I TË DHËNAVE

Në përputhje me ligjin nr.124/2024 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR), ju gëzoni një sërë të drejtash në lidhje me përpunimin e të dhënave tuaja personale nga Jet. Këto të drejta mund të ushtrohen në çdo kohë, në përputhje me kushtet dhe kufizimet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Në veçanti, ju keni:

- Të drejtën e aksesit, për të kërkuar konfirmim nëse të dhënat tuaja personale përpunohen nga Jet dhe, nëse po, për të marrë informacion mbi kategoritë e të dhënave, qëllimet e përpunimit dhe mënyrën e përdorimit të tyre.
- Të drejtën e korrigjimit, për të kërkuar përditësimin ose korrigjimin e të dhënave personale që janë të pasakta, të paplota ose të vjetruara.
- Të drejtën e fshirjes ("e drejta për t'u harruar"), për të kërkuar fshirjen e të dhënave personale në rastet kur ato nuk janë më të nevojshme për qëllimet për të cilat janë mbledhur, kur tërhiqni pëlqimin, ose kur përpunimi është i paligjshëm, përveç rasteve kur ligji parashikon ruajtjen e tyre.
- Të drejtën e kufizimit të përpunimit, për të kërkuar pezullimin e përkohshëm të përpunimit të të dhënave personale në rrethana të caktuara, si p.sh. kur kontestohet saktësia e të dhënave ose ligjshmëria e përpunimit.
- Të drejtën e kundërshtimit, për të kundërshtuar përpunimin e të dhënave personale në rastet kur përpunimi bazohet në interesin legjitim të Jet, përfshirë, kur është e zbatueshme, përpunimin për qëllime marketingu.
- Të drejtën për tërheqjen e pëlqimit, në çdo kohë, për përpunimet që bazohen në pëlqimin tuaj, pa cenuar ligjshmërinë e përpunimit të kryer përpara tërheqjes së tij.
- Të drejtën për të paraqitur ankesë, nëse konsideroni se përpunimi i të dhënave tuaja personale cenon legjislacionin në fuqi, pranë autoritetit mbikëqyrës kompetent për mbrojtjen e të dhënave personale.

Jet angazhohet të trajtojë çdo kërkesë të paraqitur nga subjektet e të dhënave në mënyrë transparente dhe brenda afateve ligjore të parashikuara nga GDPR. Për ushtrimin e këtyre të drejtave ose për çdo pyetje në lidhje me këtë Politikë Privatësie, ju mund të na kontaktoni përmes të dhënave të kontaktit të publikuara në website.

8. KONTAKT

Për çdo pyetje, kërkesë ose sqarim në lidhje me këtë Politikë Privatësie, me mënyrën se si Jet përpunon të dhënat tuaja personale, ose për ushtrimin e të drejtave tuaja si subjekt i të dhënave në përputhje me ligjin nr. 124/2024 për mbrojtjen e të dhënave personale dhe rregullores GDPR, ju mund të na kontaktoni në çdo kohë.

Jet ka caktuar një pikë kontakti të dedikuar për çështjet e mbrojtjes së të dhënave personale, e cila është përgjegjëse për trajtimin e kërkesave që lidhen me privatësinë dhe për sigurimin e

përputhshmërisë me legjislacionin në fuqi.

Të gjitha kërkesat ose pyetjet në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale mund të drejtohen në adresën e mëposhtme të email-it:
dpo@jet-bank.com

Jet angazhohet të trajtojë çdo komunikim të tillë në mënyrë konfidenciale dhe të përgjigjet brenda afateve ligjore të parashikuara legjislacioni në fuqi.